



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 40

2001

Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.57, datë 3.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.981, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	1255
Vendim i GJK nr.60, datë 4.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.949, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.31.....	1256
Vendim i GJK nr.61, datë 5.7.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.4184, datë 17.12.1996 të Gjykatës së Rrethit të Durrësit dhe nr.V-6, datë 27.10.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	1258
Vendim i GJK nr.62, datë 5.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.971, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.	1260

Vendim i GJK nr. 63, datë 5.7.2001	Me objekt pavlefshmërinë e vendimit nr.928, datë 27.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe vendimit datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.12 Lezhë.....	1262
Vendim i GJK nr.64, datë 3.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.925, datë 27.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpalljen fitues të kandidatit Durim Hushi	1264
Vendim i GJK nr.65, datë 6.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.987, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	1266
Vendim i GJK nr.66, datë 6.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.932, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	1267
Vendim i GJK nr.67, datë 12.7.2001	Me objekt pavlefshmërinë e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.27.....	1268
Vendim i GJK nr.68, datë 13.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.960, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	1270
Vendim i GJK nr.69, datë 12.7.2001	Me objekt shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit nr.932, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rishikimin e procesit zgjedhor deri në përsëritjen e zgjedhjeve në zonën elektorale nr.34.....	1271
Vendim i GJK nr.71, datë 11.7.2001	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.003, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke shpallur të pavlefshme zgjedhjet në zonën zgjedhore nr.24, si dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.....	1273

V E N D I M
Nr.57, datë 3.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Petrit Ploçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 3.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.69 Akti që u përket:

KËRKUES: 1. AGRON DUKA, kandidat i pavarur në zonën zgjedhore nr.25, Shijak, përfaqësuar nga avokat Arben Vani, me prokurë.

2. OSMAN METALLA, kandidat i Bashkimit për Fitore, përfaqësuar nga avokat Arben Ristani, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.

2. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.25 SHIJAK, përfaqësuar kryetari Edmond Isaku.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.981, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

Kërkuesi Agron Duka:

- Të gjitha fletët e votimit të konsideruara të pavlefshme janë të vlefshme në favorin tim.
- Ka manipulime e parregullsi në procesverbal, prandaj duhet organizuar rinumërimi i fletëve të votimit.

2. Kërkuesi Osman Metalla:

- Tabelat e rezultateve për qendrat e votimit nr.8 e 9 Komuna Rrashbull nuk pasqyrojnë të vërtetën e, si rrjedhojë, nuk duhet të përfshihen në rezultatet e zonës. Tabelat e rezultateve në qendrat e votimit nr.6 Komuna Rrashbull dhe nr.8 e 9 Komuna Xhafzotaj janë të rregullta dhe nuk është paraqitur asnjë provë për t'i kundërshtuar ato.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, pretendimet e palëve, administroi provat dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Pas votimit në raundin e parë dhe pas ardhjes së procesverbaleve të komisioneve të qendrave të votimit, Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.25 ka nxjerrë rezultatet dhe i ka pasqyruar në tabelën përmbledhëse të rezultateve. Sipas kësaj table, kërkuesi Agron Duka ka fituar 7 046 vota nga 14 138 vota të vlerësuara të vlefshme në të gjithë zonën, ndërsa kandidati i Bashkimit për Fitore, Osman Metalla, ka fituar 6 716 vota. Asnjëri prej kandidatëve nuk ka fituar shumicën absolute të votave të vlefshme për të dalë fitues, siç përcaktohet në nenin 63/1 të Kodit Zgjedhor.

Në tabelën përmbledhëse, komisioni i zgjedhjeve të zonës ka pasqyruar vërejtjet e të dy përfaqësuesve të kandidatëve. Së pari, të përfaqësuesit të kandidatit Osman Metalla për parregullsi e shkelje të ligjit në qendrat e votimit nr.8 e 9 Rrashbull dhe së dyti, të përfaqësuesit të kandidatit të pavarur Agron Duka për parregullsi e shkelje të ligjit në qendrat e votimit nr.6 Komuna Rrashbull dhe nr.8 e 9 Komuna Xhafzotaj.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.981, datë 29.6.2001, ka vendosur të mos shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë zonë dhe ka urdhëruar përsëritjen e zgjedhjeve në pesë qendra votimi.

Ky vendim nuk i jep përgjigje pretendimeve të paraqitura në ankesat e kërkuesve. Në kërkesat e tyre ka pretendime për manipulime të numrit të votave dhe për nevojën e rinumërimit apo rivotimit edhe në qendra të tjera votimi të asaj zone, për vlerësimin e drejtë të 545 fletëvotimeve të konsideruara të pavlefshme që mund të ndryshojnë krejtësisht rezultatin, në kushtet kur kandidatit Agron Duka i nevojiten vetëm 24 vota për të dalë fitues. Këto probleme nuk mund të gjejnë zgjidhje të drejtë vetëm me rivotimin në pesë qendra votimi prandaj duhet të zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve midis të dy kandidatëve.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit nr.981, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.25.
- Urdhërimin për zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve midis kandidatëve për deputetë Agron Duka, i pavarur dhe Osman Metalla, Bashkimi për Fitore.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.60, datë 4.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 4.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.73 Akti që i përket:

KËRKUES: MUHAMET BELA

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.

2. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.31, përfaqësuar nga kryetari Korab Lita.
3. SHABAN MEMIA, përfaqësuar nga avokat Arben Ristani.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.949, datë 28.06.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.31.

BAZA LIGJORE:Nenet 131 e 141/1 të Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.949, datë 29.6.2001 ka shpallur fitues kandidatin për deputet zotit Shaban Memia, si dhe ka shpallur rezultatin e përqindjes së proporcionalit të subjekteve zgjedhore, duke lënë kështu në fuqi vendimin nr.25, datë 25.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.31.

Kandidati për deputet Muhamet Bela, si në kërkesën e paraqitur prej tij, ashtu dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes kërkoi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.31 në të gjitha qendrat e saj të votimit, për shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Kërkuesi, duke iu referuar këtyre shkeljeve, pretendoi se: në 7 qendra është bërë votimi në lokale private; procesverbalet e qendrave të votimit janë plotësuar me të njëjtin shkrim dhe kanë një numër votuesish të ndryshëm në raport me listat; në katër qendra votimi procesverbalet janë pa nënshkrimin e sekretarëve të tyre; në tri qendra votimi kryetarët e komisioneve janë edhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; dy kuti të qendrave të votimit janë gjetur të hapura, kurse një kuti e mbyllur nuk i përket zonës 31; në qendrën e votimit nr.8 ka patur çrregullime në lista, presione në votime dhe se edhe në qendra të tjera janë vërtetuar shkelje të ndryshme të ligjit.

Në kundërshtim me pretendimet e mësipërme të kërkuesit, rezultoi se në 7 qendra votimi të caktuara në lokale private dhe konkretisht në ato me nr.2, 2/1, 5, 5/1, 6, 15 dhe 15/1 është lejuar të zhvillohet votimi për shkaqe objektive nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rreth këtij fakti dha shpjegimet e nevojshme përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe një veprim i tillë konsiderohet i drejtë sepse ligjërisht bazohet në nenin 92 shkronja "a" të Kodit Zgjedhor.

Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendohet prej kërkuesit lidhur me plotësimin e procesverbaleve të qendrave të votimit etj., gjatë gjykimit rezultoi se procesverbalet e të gjitha qendrave të votimit që ka zona nr.31 janë firmosur pa përjashtim unanimitisht nga anëtarët e Komisionit, të cilët nuk kanë bërë asnjë vërejtje ose kundërshtim për përmbajtjen e tyre. Ky fakt tregon për zhvillimin normal të procesit zgjedhor në të gjithë zonën dhe mbështetet edhe në dokumente të tjera të firmosura unanimitisht edhe nga komisioni i zonës nr.31, siç janë tabela e deputetëve të listës shumëmemërore model 40/1, vendimi nr.25, datë 25.6.2001, etj.

Vetëm zëvendëskryetari i komisionit të zonës zgjedhore Shpëtim Kotarja ka firmosur me rezervë tabelën model 39/1, duke iu referuar protokollit të shkeljeve në zonën 31, mbajtur në datën 25.6.2001 prej përfaqësuesit të kandidatit Muhamet Bela. Në lidhje me këto shkelje, që përbëjnë në fakt objektin e kërkesës në shqyrtim, duhet thënë se ato jo vetëm që nuk u vërtetuan gjatë gjykimit të çështjes me provat e paraqitura prej kërkuesit, por shumica prej tyre, siç del nga renditja e mësipërme, nuk çmohen si të tilla prej gjykatës që të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve, ashtu siç kërkohet prej pikës 1 të nenit 113 të Kodit Zgjedhor.

Duke u nisur nga sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar dhe si e tillë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.61, datë 5.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Zija Vuci,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 29.5.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.40 Akti që i përket:

KËRKUES: VASIL PANO, përfaqësuar nga avokate Valentina Shehu, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. VIKTORE MULAJ, në mungesë.
2. NIKOLLA SEMENA, përfaqësuar nga bashkëshortja Niqi Semena.
3. PALUSH SEMENA
4. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT Të PRONAVE PRANë BASHKISë DURRËS, në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.4184, datë 17.12.1996 të Gjykatës së Rrethit të Durrësit dhe nr.V-6, datë 27.10.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin e këtyre vendimeve, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Gjykata e Rrethit të Durrësit, Gjykata e Apelit të Durrësit dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e kanë zgjidhur çështjen drejt. Ato duhej të anulonin vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që iu kthen trashëgimtarëve të Mark Semenës edhe truallin prej 650 m2, sepse ky nuk është i tyre. Këtë truall, ka pretenduar kërkuesi, ia ka blerë trashëgimlënësit të tyre së bashku me shtëpinë që në vitin 1967 dhe prej asaj kohe e deri më sot e ka pasur dhe e ka në posedim.

Ai ka thënë se për këtë zgjidhje të padrejtë i është drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimit nr.4184, datë 17.2.1996, por jo vendimet e rishikimit, siç shprehet Kolegji në vendimin e tij të mospranimit të rekursit. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë duhet të gjykonte mbi atë vendim që ka kërkuar ai dhe jo çfarë i pëlqen asaj.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, kërkuesin dhe avokatin e tij, subjektet e interesuara të pranishëm, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.6, datë 27.10.2000, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Vasil Pano si të pabazuar në ligj.

Në këtë gjykim nuk janë respektuar kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës për një proces të rregullt ligjor. Kjo shkelje me karakter kushtetues është e lidhur me cenimin e parimit të njohur procedural, sipas të cilit gjykata duhet të shprehet për gjithçka që i kërkohet dhe vetëm për atë që i kërkohet”.

Shmangien nga ky parim Gjykata Kushtetuese e gjen duke bërë krahasimin e pjesës arsyetuese të vendimit të sipërpërmendur me objektin dhe përmbajtjen e rekursit që ka ushtruar kërkuesi.

Ndryshe nga sa ka parashtruar ky i fundit, i cili ka kërkuar shfuqizimin vetëm të vendimit nr.4184, datë 17.12.1996 të Gjykatës së Rrethit të Durrësit për shkaqe që lidhen me themelin e çështjes, Kolegji Seleksionues ka marrë në shqyrtim vendime të tjera që nuk kanë qenë objekt i këtij rekursi.

Duke iu referuar përmbajtjes së këtyre vendimeve që kanë lidhje me padinë tjetër të kërkuesit për rishikimin e vendimit të kundërshtuar prej tij, Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si argument të vetëm për mospranimin e rekursit, ka përdorur mungesën e shkaqeve të rishikimit, të parashikuara nga neni 495 i Kodit të Procedurës Civile.

Kështu, megjithëse kërkuesi nuk ka pretenduar për ekzistencën e ndonjërit prej këtyre shkaqeve, Kolegji në fjalë është shprehur se ky rekurs nuk duhet pranuar për shkak se në këtë rast nuk ndodhemi përpara provave të reja me shkresë ose përpara ndonjë vendimi penal të formës së prerë që të vërtetojë dëshminë apo ekspertimin e rremë.

Pra nga përmbajtja e vendimit objekt kërkese del se Kolegji Seleksionues në shqyrtimin e kësaj çështje ka dalë jashtë kufijve të rekursit. Tjetër gjë i ka parashtruar atij kërkuesi dhe për tjetër gjë është shprehur ai. Madje, në vend që të analizonte shkaqet për të cilat i është kërkuar prishja e vendimit nr.4184, datë 17.12.1996 të Gjykatës së Rrethit të Durrësit, ai ka analizuar shkaqe të tjera që nuk janë parashtruar në rekurs.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.V-6, datë 27.10.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kam mendim të kundërt me shumicën dhe jam për rrëzimin e kërkesës.

Është e vërtetë se Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si argument të vetëm për mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesi Vasil Pano, ka përmendur vendime të tjera që ky nuk i ka kontestuar ose ka analizuar shkaqe që nuk janë parashtruar në rekurs, por kjo nuk do të thotë se zgjidhja që i ka dhënë çështjes nuk pajtohet me Kushtetutën.

Për mendimin tim, në këtë rast konkret nuk ndodhemi përpara një procesi të parregullt ligjor. Kjo për faktin se Kolegji e ka tërhequr për shqyrtim dhe e ka pasur parasysh edhe çështjen civile që lidhet me vendimin nr.4184, datë 17.12.1996 të Gjykatës së Rrethit të Durrësit.

Nga ana tjetër, ai ka pasur parasysh edhe rekursin kundër këtij vendimi. Në këtë rekurs nuk ngrihen shkaqe për shkelje me karakter kushtetues, por vetëm probleme që kanë të bëjnë me çmimin e provave.

A N Ë T A R
Z. Vuci

V E N D I M Nr.62, datë 5.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Petrit Pilloçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 5.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.76 Akti që i përket:

KËRKUES: THOMA MIÇO

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

4. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
5. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.98, në mungesë.
6. THEODHORI BEJ, përfaqësuar nga avokat Ardian Nuni.
7. LEONARD DEMI, përfaqësuar nga avokat Kreshnik Spahiu.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.971, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nenet 113 e 141 të Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kryetarin Fehmi Abdiu, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.971, datë 29.6.2001 ka vendosur: “Të shpallë rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.98, duke mos njohur fitues asnjë kandidat për deputet. Zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.98, më 8.7.2001, midis kandidatit për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zotit Theodhori Bej dhe kandidatit të pavarur, zotit Leonard Demi”.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi Thoma Miço, i cili ka kërkuar deklarinim pjesërisht të pavlefshëm të rezultatit të votimeve në zonën zgjedhore nr.98 Delvinë, duke parashtruar se një vëzhgues, përfaqësues i PBDNJ-së, është lejuar të marrë pjesë në procesin e votimit; është bërë manipulimi i procesit të votimit, kanë votuar shtetas që banojnë jashtë shtetit; se dokumentet e Komisionit të Qendrave të Votimit janë plotësuar në Komisionin Zonal Zgjedhor e se nuk janë vlerësuar drejt fletët e pavlefshme të votimit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes u konstatua se kërkesa e kërkuesit është e pabazuar. Ai ka paraqitur para Gjykatës deklarata personale të personave të veçantë për të provuar pretendimet e tij, ndërkohë që përfaqësuesit e tij pranë KQV-ve nuk kanë parashtruar rezerva në përfundim të procesit zgjedhor e as në momentin e nënshkrimit të procesverbalit. Po kështu, nuk kanë paraqitur pretendime për parregullsi në procesin zgjedhor as përfaqësues të veçantë të KZZ-së.

Veç këtyre, ai nuk ka paraqitur ankim as në organet gjyqësore e as në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në këto rrethana, kërkesa e tij konform nenit 113 të Kodit Zgjedhor, duhet rrëzuar si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr. 63, datë 5.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Petrit Pilloçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Zija Vuci,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 5.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.77 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. PARTIA SOCIALISTE, DEGA E LEZHËS
2. PARTIA SOCIALDEMOKRATE, DEGA E LEZHËS
3. RAMADAN HASANAJ, përfaqësuar nga avokat Qemal Stafa
SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. ZEF GJOKA

O B J E K T I:

Pavlefshmëria e vendimit nr.928, datë 27.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe vendimit datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.12 në Lezhë.

Kundër këtyre vendimeve kanë bërë ankim kërkuesit, duke parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

Të dy këto vendime nuk pasqyrojnë realitetin. Në veçanti, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nuk shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.12, vjen në kundërshtim me kompetencat që i njihen këtij Komisioni nga neni 153 i Kushtetutës.

Nga ana tjetër, shpallja nga ky Komision i Zgjedhjeve në qendrën e votimit nr.8 Balldre, nuk është real, pasi në këtë qendër votimi nuk janë zhvilluar fare zgjedhjet.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është treguar i njëanshëm, pasi nuk i ka dhënë përgjigje kërkesave të herëpashershme që i janë ngritur nga kërkuesit për shkelje të rënda ligjore që kanë ndodhur në rezultatin e zgjedhjeve.

Konkretisht, shkeljet janë në këto drejtime:

a) Kryetari i Komisionit Zonal Zgjedhor është caktuar Gjovalin Gjeloši, i cili është i proceduar penalisht për shpërdorim detyre.

b) Ky, në kundërshtim me nenet 3 e 35 të Kodit Zgjedhor iu ka dorëzuar qendrave të votimit nr.1, 2 e 3 në Shëngjin pa praninë e komisionerëve të PS-së e PSD-së dhe nuk ka reaguar për vulën e qendrës së votimit nr.3 në Shëngjin që u gjet e prishur.

c) Nga ana e tij, komisionerët e propozuar nga PS-ja dhe PSD-ja janë zëvendësuar me të tjerë në tre qendra votimi pa dijeninë e këtyre subjekteve.

ç) Si anëtar i Komisionit Zonal Zgjedhor është emëruar Ndue Perndoka si përfaqësues i PBDNJ-së, megjithëse nuk është banor i zonës nr.12 (neni 32/b i Kodit Zgjedhor).

d) Si sekretar i kësaj zone është emëruar Agim Ibro pa konsensus ose kandidaturë alternative.

dh) Është caktuar Kryetar i Qendrës së Votimit në Balldre Dedë Keta, ndonëse është i zgjedhur këshilltar në Komunën e Balldrenit (neni 43/4 i Kodit Zgjedhor).

e) Më datën 24.6.2001 është lejuar fushatë propagandistike nëpërmjet materialeve fotografike në selinë e Komisionit Zonal Zgjedhor.

ë) Në disa qendra votimi janë konstatuar mospërputhje midis numrit të votuesve dhe fletëve të votimit.

f) Janë lejuar dy persona të punojnë për plotësimin e tabelës së rezultateve, pa qenë anëtarë të Komisionit. Kryetari i Komisionit Zonal Zgjedhor dhe sekretari kanë marrë në dorëzim kuti votimi të hapura ose i kanë hapur ato pa praninë e nënkryetarit dhe të komisionerëve tanë. Nuk kanë verifikuar seritë e fletëve të votimit etj.

Në këto rrethana kërkohet shfuqizimi i vendimeve objekt i kërkesës dhe përsëritja e zgjedhjeve në krejt zonën zgjedhore nr.12.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Zija Vuci, kërkuesit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Zgjedhjeve të Zonës nr.12, me vendimin datë 26.6.2001 ka vendosur të shpallë fitues në zgjedhjet për deputet në Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara më datën 24 qershor 2001, kandidatin e pavarur Zef Gjoka dhe si subjekt të listës shumëmemërore Partinë Demokratike Bashkimi për Fitore.

Ky vendim është ndryshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili me vendimin nr.928, datë 27.6.2001 ka vendosur mosshpalljen e rezultatit përfundimtar në këtë zonë zgjedhore, shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në qendrën e votimit nr.8 Balldre dhe përsëritjen e tyre në këtë qendër votimi më datën 8 korrik 2001.

Në kundërshtim me sa ka pretenduar kërkuesi gjatë gjykimit dhe në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kjo zgjidhje e pranuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk përbën kapërcim të kompetencave që i njihen atij nga neni 153 i Kushtetutës.

Në bazë të kësaj dispozite, ky organ është autorizuar të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, por kjo nuk do të thotë që s'ka të drejtë të vendosë ndryshe kur konstaton shkelje të ligjit mbi zgjedhjet. Kur këto shkelje janë të rëndësishme, ai përkundrazi është i detyruar të mos shpallë asnjë rezultat dhe, sipas rastit, të vendosë pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në krejt zonën elektorale ose në pjesë të veçanta të saj.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera të kërkuesit në lidhje me caktimin e pjesëmarrësve të komisionit të zgjedhjeve të zonës ose të komisioneve të qendrave të votimit të ngritura në zonën e tij.

Kështu, fakti se kryetari i kësaj zone ndiqet penalisht nuk përbën pengesë ligjore për ushtrimin e këtij funksioni nga ana e tij.

Po kështu, edhe caktimi si anëtar ose sekretar i komisionit të zonës zgjedhore apo si anëtarë të komisioneve në disa qendra votimi i personave që nuk përmbushin kërkesat e neneve 32 pika 6 dhe 43 pika 1 e 4 të Kodit Zgjedhor janë probleme që aktualisht nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese. Kjo për arsye se kërkuesi dhe subjekti i tij zgjedhor, për zgjidhjen e ankesave në këtë drejtim përveç rrugës administrative, nuk kanë konsumuar në kohë edhe rrugën gjyqësore, ashtu siç parashikon neni 140 i Kodit Zgjedhor.

Të njëjtin qëndrim mban Gjykata Kushtetuese edhe përsa i përket pretendimeve të tjera që ka ngritur kërkuesi në lidhje me parregullsitë, që sipas tij, janë konstatuar gjatë numërimit të votave dhe përpilimit të dokumentacionit përkatës mbi rezultatet e zgjedhjeve në disa qendra votimi.

Pretendime të tilla janë të paargumentuara. Vetë kërkuesi gjatë gjykimit pranoi se komisionerët e caktuar nga subjektet zgjedhore që e kanë mbështetur, i kanë nënshkruar procesverbalet e këtyre qendrave të votimit pa bërë vërejtjet përkatëse.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk mund t'i marrë për bazë këto pretendime dhe të cenojë vendimet e kundërshtuara nga kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.64, datë 3.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Alfred Karamuco,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtare e	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 3.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.68 Akti që i përket:

KËRKUES: DURIM HUSHI, kandidat për deputet i Partisë Socialiste, përfaqësuar nga avokat Ilia Olldashi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. OMER STRINGA, kandidat për deputet i koalicionit Bashkimi për Fitore.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.925, datë 27.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe shpallja fitues e kandidatit Durim Hushi.

Kërkuesi për shfuqizimin e vendimit nr.925, datë 27.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka parashtruar këto shkaqe:

- Në qendrat e votimit nr.49 dhe 51 të zonës zgjedhore nr.50, komisionet e qendrave të votimit kanë shpallur në rezultatet e votimit respektivisht 184 dhe 22 vota të pavlefshme në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, ndërkohë që këto vota kanë qenë të vlefshme dhe në favor të kërkuesit.
- Qytetarëve u është mohuar e drejta kushtetuese politike e votës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, subjektet e interesuara, si dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.925, datë 27.6.2001 ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr.50 duke mos njohur fitues asnjë kandidat për deputet, si dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në këtë zonë më datën 8 korrik 2001 ndërmjet kandidatit për deputet të Partisë Socialiste, zotit Durim Hushi dhe kandidatit të koalicionit Bashkimi për Fitore, zotit Omer Stringa.

Në raundin e parë të zgjedhjeve kërkuesi Durim Hushi ka marrë 5 253 vota, ose 49,06% dhe zoti Omer Stringa ka marrë 4 354 vota ose 40,66%. Në bazë të nenit 63 të Kodit Zgjedhor asnjëri nga kandidatët për deputet nuk ka arritur të sigurojë shumicën absolute të votave të vlefshme të zgjedhësve, që rezultojnë 10 707 sipas Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.50.

Kërkuesi ka pretenduar se 206 vota të pavlefshme të shpallura padrejtësisht nga komisionet e qendrave të votimit nr.49 dhe 51, nëse do të rezultonin në favor të tij, atëherë ai do të shpallej fitues

që në raundin e parë, pasi e realizoi shumicën absolute të votave të vlefshme.

Në këto kushte, meqënëse pretendimi i kërkuesit lidhej drejtpërdrejt me vendimin e shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese vendosi, në bazë të nenit 107 pika 2 të Kodit Zgjedhor të urdhërojë, hapjen e kutive të votimit të qendrave të votimit nr.49 dhe 51 të Zonës Zgjedhore nr.50.

Fillimisht u hap kutia e votimit që i përkiste qendrës së votimit nr.49. Nga verifikimi i 184 votave të shpallura si të pavlefshme nga komisioni i kësaj qendre votimi rezultuan se 19 vota ishin të pavlefshme, ndërsa diferenca prej 165 votash u konsideruan të vlefshme nga Gjykata Kushtetuese. Për kërkuesin Durim Hushi rezultuan 97 vota të vlefshme, ndërsa për kandidatin e koalicionit Bashkimi për Fitore Omer Stringa 53 vota. Duke i shtuar numrit të votave 5 253 që kërkuesi ka marrë në raundin e parë të zgjedhjeve shifrën 97 të rivlerësuara pas hapjes së kutive si vota të vlefshme në favor të tij, rezultoi se kërkuesi nuk arrinte shumicën absolute të votave për t'u shpallur fitues që në raundin e parë. Meqënëse në kutinë e qendrës së votimit nr.51 kishte 22 vota të pavlefshme, shifër e cila nuk influenconte në ndryshimin e rezultatit, Gjykata Kushtetuese e konsideroi të panevojshëm vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit të votave.

Nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se vendimi nr.925, datë 27.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nuk kishte shpallur asnjë fitues dhe kishte vendosur zhvillimin e raundit të dytë midis tyre nuk duhej shfuqizuar.

Gjithashtu, lidhur me fuqinë e vendimit të saj, Gjykata Kushtetuese konkludon se duhet të zbatohet nenin 26 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "e" dhe 132 të Kushtetutës, si dhe në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.65, datë 6.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli,	Anëtar i ““
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Petrit Pilloçi,	Anëtar i ““
Tefta Zaka,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 5.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.79 Akti që i përket:

KËRKUESE: ARTA DADE, kandidate për deputete në zonën zgjedhore nr.63 në Lushnjë, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. AGIM RREDHI, kandidat për deputet i pavarur.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.987, datë 29.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kërkuesja ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

1. Të dhënat e procesverbalit për rezultatin e votimeve në qendrën e votimit nr.4 të fshatit Muçias nuk korrespondojnë me të dhënat e hedhura në tabelën e rezultateve të hartuara nga Komisioni Zonal Zgjedhor sepse nga 283 vota të vlefshme janë shënuar 402 të tilla në procesverbalin e zonës.

2. Në procesverbalin e qendrës së votimit nr.2 Divjakë, 84 votat e pavlefshme i janë shtuar kandidatës së PDK-së.

3. Në qendrën e votimit nr.4 Mertish, janë hedhur vota në kutinë e votimit në mënyrë të paligjshme.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkueses, subjektet e interesuara, u njoh me përmbajtjen e dokumenteve në dosje dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesja Arta Dade ka qenë kandidate për deputete e Partisë Socialiste të Shqipërisë në zonën zgjedhore nr.63 Lushnjë dhe, sipas tabelës së rezultateve të zonës të nënshkruar nga komisioni i zonës, ajo ka fituar 7686 vota të vlefshme nga 15 448 vota të vlerësuara të vlefshme për gjithë zonën që përbëjnë 49.75 % të tyre. Në bazë të këtyre rezultateve, Komisioni i Zonës Zgjedhore, me vendimin nr.11, datë 27.6.2001, ka shpallur rezultatet e zgjedhjeve në zonë dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për deputet midis kërkueses Arta Dade dhe kandidatit të pavarur Agim Rredhi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.987, datë 29.6.2001 ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve në atë zonë, duke mos njohur fitues asnjë kandidat për deputet dhe ka urdhëruar zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve më datën 8 korrik 2001.

Si tabela e rezultateve, ashtu edhe vendimet e Komisionit Zonal Zgjedhor e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë të gabuara sepse kërkuesja Arta Dade ka fituar shumicën absolute të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë marrë pjesë në votim në atë zonë dhe ka dalë deputete qysh në raundin e parë të zgjedhjeve.

Për të vërtetuar pretendimet e veta, kërkuesja paraqiti kopjen e procesverbalit të marrë prej saj për rezultatet e zgjedhjeve në qendrën e votimit nr.4 të Komunës Rremas nga i cili rezultoi se janë 283 fletë votimi të vlefshme dhe jo 401 siç figurojnë në procesverbalin përmbledhës të 5 qendrave të votimit (model 39) dhe në procesverbalin përmbledhës të zonës zgjedhore. Pas kundërshtimit të subjektit të interesuar Agim Rredhi, Gjykata Kushtetuese urdhëroi hapjen e kutisë përkatëse të votimit e numë

rimin e votave nga rezultoi se pretendimi i kërkueses është i vërtetë.

Duke u nisur nga sa sipër, numri i votave të vlefshme nuk është 15 448 por 118 më pak, pra 15 330 vota. Meqënëse kërkuesja ka fituar në raundin e parë 7686 vota, pra 21 vota më shumë se gjysma e numrit të votave të vlefshme (7665) ajo del drejtpërdrejt kandidate fituese për deputete sipas nenit 63/1 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/e të Kushtetutës,

nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe neneve 113 e 141 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.987, datë 29.6.2001.
- Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shpallë fituese kandidaten për deputete të Partisë Socialiste, znj. Arta Dade.
- Anullimin e raundit të dytë të zgjedhjeve në zonën nr.63.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.66, datë 6.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Petrit Pllloçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 6.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.83 Akti që i përket:

KËRKUES: FILIP ÇAKULI, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.100, përfaqësuar nga avokat Virgjil Karaj.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. STEFAN ÇIPA, në mungesë.
3. ANDREA MIÇO, në mungesë.
4. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.100, përfaqësuar nga Resmi Iljazi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.932, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Filip Çakuli ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.932, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe përsëritjen e zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.100.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, kërkuesi deklaroi personalisht para Gjykatës se heq dorë nga kërkesa e tij.

Në këto kushte çështja duhet të pushohet.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/e të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe neneve 113 e 141 të Kodit Zgjedhor, njëzëri,

V E N D O S I:

- Pushimin e çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.67, datë 12.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Petrit Pilloçi,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 12.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.94 Akti që i përket:

KËRKUES: ZIHNI BEQIRAJ, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.27, përfaqësuar me deklaram nga avokat Nikolla Kondakçi.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. PËLLUMB BERISHA, përfaqësuar me deklaram nga avokat Halil Kopani.
3. KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR.27, përfaqësohet nga Mehmet Berisha, kryetar.

O B J E K T I:

Pavlefshmëria e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për zonën zgjedhore nr.27.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.27, me vendimin nr.008, datë 26.6.2001 ka shpallur deputet të drejtpërdrejtë të zonës zotin Pëllumb Berisha, përfaqësues i subjektit zgjedhor “Bashkimi për Fitore”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.927, datë 28.6.2001 ka vendosur shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve në zonën nr.27, duke njohur si fitues kandidatin Pëllumb Berisha.

Në kërkesën e tij për pavlefshmëri të rezultatit përfundimtar, kërkuesi Zihni Beqiraj pretendon se gjatë procesit zgjedhor janë kryer shkelje në lidhje me formimin e komisioneve të qendrave të votimit dhe atij të zonës, votime nga kryefamiljarët për llogari të personave të tjerë, mosrakovim të të dhënave në tabelën e rezultateve për disa qendra votimi, marrjen e dokumentacionit nga Komisioni i Zonës Zgjedhore pa i kontrolluar sipas ligjit dhe mospasqyrim të gjendjes reale në tabelat e rezultatit të votimit.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuesit për formimin e komisioneve të qendrave të votimit dhe atij të zonës, nuk mund të merren në shqyrtim për faktin se për to është bërë ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit, e cila e ka zgjidhur çështjen përfundimisht.

Përsa i përket pretendimeve të tjera, ato janë të karakterit të përgjithshëm, të pambështetura në prova dhe pa argumentuar ndikimin e shkeljeve në rezultatin e votimit. Por, më i rëndësishëm është fakti se për këto shkelje për të cilat pretendohet pavlefshmëria e zgjedhjeve, kërkuesi nuk ka paraqitur fare ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, e cila sipas nenit 141 të Kodit Zgjedhor shqyrtton ankimet kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk mund ta shqyrtojë këtë çështje.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 të Kushtetutës nenit 141 të Kodit Zgjedhor, si dhe neneve 67 e 72 të Ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.68, datë 13.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i ““
Gjergj Sauli,	Anëtar i ““
Kujtim Puto,	Anëtar i ““
Kristofor Peçi,	Anëtar i ““
Tefta Zaka,	Anëtar i ““
Petrit Plloçi,	Anëtar i ““
Sokol Sadushi,	Anëtar i ““
Alfred Karamuço,	Anëtar i ““

me sekretare Drita Panda, më datë 9.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.71 Akti që u përket:

KËRKUES: 1. ARBEN LIKA, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.1, përfaqësuar me prokurë nga avokate Denisa Daka.

2. RUZHDI DULAJ, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.1, përfaqësuar me prokurë nga avokatët Denisa Daka e Vasil Plaku.

SUBJEKTE TË INTERESUAR:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. GJOVALIN BZHETA, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.1, përfaqësuar me prokurë nga avokat Adnor Shameti.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.960, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, kërkuesit dhe përfaqësuesin e tyre, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesit Arben Lika e Ruzhdi Dulaj kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ku pretendojnë se vendimi nr.960, datë 29.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.1, është i pambështetur në ligj e në prova e si i tillë duhet të shfuqizohet e për pasojë zgjedhjet në këtë zonë të shpallen të pavlefshme.

Nga shqyrtimi i materialeve të çështjes ka rezultuar e provuar se të dy kërkuesit nuk rezultojnë të kenë bërë ankim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj vendimit nr.11, datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.1, që shpalli rezultatet e zgjedhjeve si dhe kandidatin fitues zotin Gjovalin Bzheta. Në këtë mënyrë, kërkuesit janë paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pa konsumuar mjetet e tjera ligjore të ankimit në rrugën administrative e për pasojë ata, në kuptim të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës dhe neneve 107 e 140 të Kodit Zgjedhor nuk legjitimohen të bëjnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronjat “e dhe f” të Kushtetutës si dhe nenit 140 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M

Nr.69, datë 12.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Petrit Pilloçi,	Anëtar i	““

Sokol Sadushi, Anëtar i ““
Zija Vuci, Anëtar i ““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.90 Akti që i përket:

Kërkues: Bashkimi për Fitore, Visar Zhiti, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.34, përfaqësuar nga avokat Halil Kopani.

Subjekte të interesuar:

1. Komisioni Qendror i zgjedhjeve, përfaqësuar nga zoti Sokol Lamaj.
2. Spartak Poçi, kandidat për deputet në zonën zgjedhore nr.34, përfaqësuar me prokurë nga avokatët Ilir Panda e Mirash Martini.

O B J E K T I:

Shpallja e pavlefshmërisë së vendimit nr.932, datë 28.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe rishikimi i procesit zgjedhor deri në përsëritjen e zgjedhjeve në zonën elektorale nr.34.

Baza ligjore: Nenet 134 pika shkronja “f” të Kushtetutës dhe 141 pika 1 e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Në mesnatën e datës 24 e 25.6.2001 kandidati i Partisë Socialiste Spartak Poçi, i shoqëruar nga badigardët e tij ka hyrë në mjediset e Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.34 në kohën që komisionet e qendrave të votimit po dorëzonin materialet e votimit. Me këtë veprim të tij ai ka cenuar rregullishmërinë e procesit zgjedhor dhe ka ndikuar në nxjerrjen e rezultatit.

Firmat e komisionerëve të qendrave të votimit nr.6 e 7 të vëna në procesverbalin për subjektet janë të falsifikuara.

Në qendrat e votimit 9, 13 e 26 nuk janë lejuar të votojnë gjithsej 83 persona, për shkak se nuk figuronin të regjistruar në listat që kanë përdorur komisionet e këtyre qendrave, ndonëse emrat e tyre ishin në listat e shpallura.

Në qendrën e votimit nr. 66 nuk janë lejuar të votojnë një numër i konsiderueshëm personash për shkak se në ora 18.00 në këtë qendër është mbyllur votimi, megjithëse në pritje për të votuar kishte plot njerëz.

Në disa qendra votimi janë shpallur të pavlefshme disa fletë votimi në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Zija Vuci, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të zhvilluara në datën 24.6.2001 Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.34 të Tiranës ka shpallur fitues kandidatin për deputet të Partisë Socialiste zotin Spartak Poçi.

Ky vendim është kundërshtuar nga subjekti elektorale “Bashkimi për Fitore” dhe përfaqësuesi i kërkuesit, zoti Visar Zhiti, por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.932, datë 28.6.2001 ka vendosur lënien në fuqi të tij.

Pretendimet e kërkuesit për shfuqizimin e këtyre vendimeve Gjykata Kushtetuese nuk i gjen të bazuara.

Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje në seancë plenare nuk u provua që subjekti i interesuar zoti Spartak Poçi ose badigardët e tij të kenë ushtruar presion ndaj komisionerëve të zonës zgjedhore

nr.34 në orët e vona të datës 24 qershor. I lartëpërmenduri e ka mohuar në mënyrë kategorike hyrjen e tij në mjediset e kësaj zone në kohën që pretendon kërkuesi. Në këto kushte kur edhe vetë ky i fundit dhe avokati i tij nuk ishin në gjendje të shpjegojnë se çfarë veprimesh kanë ndërmarrë konkretisht këta persona për të ndikuar në nxjerrjen e rezultatit të votimit, Gjykata Kushtetuese nuk krijon bindjen që në këtë zonë elektorale të ketë ndodhur shkelja e pretenduar.

Edhe kaseta filmike që ka paraqitur ai për të vërtetuar të kundërtën, nuk ka ndonjë vlerë provuese. Ajo nuk mund të rrëzojë përmbajtjen e aktit të marrjes në dorëzim të materialeve të votimit, të përpiluar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili është nënshkruar pa vërejtje dhe si i tillë ka fuqi të plotë provuese.

Të pabazuara janë edhe pretendimet e tjera që ka ngritur kërkuesi. Falsifikimi i firmave të komisionerëve në procesverbalet e qendrave të votimit nr.6 e 7, nuk vërtetohet. Në këto njësi zgjedhore të gjitha aktet që pasqyrojnë rezultatin e zgjedhjeve janë nënshkruar nga komisionerët dhe nuk rezultojnë që ndonjeri prej tyre të ketë bërë observacione.

Përsa i përket qendrave të votimit nr.9, 13 e 26 në të cilat pretendohet se kanë mbetur pa votuar gjithsej 83 zgjedhës për shkak se nuk figuronin emrat e tyre në listat zgjedhore, vlen të theksohet se komisionet në këto njësi zgjedhore kanë vepruar në përputhje me kërkesat e kodit elektorale.

Në bazë të dispozitave të këtij kodi, vetë këta zgjedhës për të realizuar të drejtën e tyre të votës duhej të ishin interesuar qysh më përpara për të arritur përfshirjen e emrave të tyre në këto lista.

Edhe pretendimin e fundit të kërkuesit që ka të bëjë me moslejimin e disa personave të votojnë pas orës 18.00 në qendrën e votimit nr.66, Gjykata Kushtetuese e konsideron të paprovuar. As në kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, as gjatë gjykimit ai nuk mundi të përcaktojë qoftë edhe përafërsisht numrin e këtyre personave. Veç sa sipër, nga aktet del se në këtë qendër votimi kryetare e komisionit ka qenë Nora Pecmarku, përfaqësuese e Bashkimit për Fitore. Duke qenë kështu dhe duke pasur edhe mbështetjen e komisionerëve të tjerë kanë ekzistuar të gjitha mundësitë që në këtë qendër votimi të vendosej vazhdimi i votimit edhe pas orës 18.00, në rast se në këtë orë ka pasur njerëz që prisnin për të votuar. Por edhe po të ketë ndodhur që me shumicë votash është vendosur e kundërta, ajo të paktën si kryetare e komisionit duhej të kishte shënuar vërejtjet e saj në procesverbalin përkatës, gjë që në të vërtetë nuk e ka bërë.

Nga ana tjetër, është për t'u theksuar se për këto dy kategori zgjedhësish që pretendohet se kanë mbetur pa votuar, nuk dihet me siguri nëse votat e tyre do të shkonin në favor të kërkuesit apo të subjektit të interesuar, zotit Spartak Poçi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 të Kushtetutës; nenit 141 të Kodit Zgjedhor si dhe të neneve 67 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

V E N D I M
Nr.71, datë 11.7.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Zija Vuci,	Anëtar i	““
Gjergj Sauli,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Alfred Karamuço,	Anëtar i	““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	““
Kujtim Puto,	Anëtar i	““
Petrit Plloçi,	Anëtar i	““
Tefta Zaka,	Anëtar i	““
Sokol Sadushi,	Anëtar i	““

me sekretare Arbenka Lalica, më datë 11.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.93 Akti që i përket:

Kërkues:MEHDI ALIMEHMETI, kandidat për deputet i koalicionit “Bashkimi për Fitore”, përfaqësuar me prokurë nga Vladimir Mulaj.

Subjekte të interesuara:

1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, përfaqësuar nga Sokol Lamaj.
2. SPARTAK BRAHO.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.003, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke shpallur të pavlefshme zgjedhjet në zonën zgjedhore nr.24, si dhe zhvillimin e raundit të dytë të zgjedhjeve.

Kërkuesi, për shfuqizimin e vendimit nr.003, datë 29.6.2001 të Komisionit Qendror të zgjedhjeve, ka parashtruar këto shkaqe:

- Në qendrat e votimit nr.10, Bashkisë së Sukthit; nr.13/1 dhe 20 të Bashkisë Manez; nr.9, 10 të Komunës së Ishmit dhe nr.5 të Komunës së Maminasit, janë hartuar procesverbale të falsifikuara të ndryshme në rezultat nga procesverbalet e rregullta që disponon kërkuesi, të cilat pasqyrojnë të dhëna fiktive në favor të Spartak Braho dhe në disfavor të tij.

Në këto 6 qendra votimi i janë shtuar gjithsej zotit Braho 1 085 vota dhe i janë ulur kërkuesit 119 vota.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, subjektet e interesuara dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.24, në bazë të tabelës së rezultateve të votimit për deputet të drejtpërdrejtë, ku rezultonte se zoti Spartak Braho kishte marrë 7 081 vota kundrejt 3 777 votave të kërkuesit, me vendimin nr.14, datë 26.6.2001, ka vendosur të shpallë deputet të kësaj zone zotin Spartak Braho.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.003, datë 29.6.2001 ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore nr.24, duke njohur si fitues kandidatin për deputet të Partisë Socialiste zotin Spartak Braho.

Kërkuesi pretendon se vendimet e Komisionit të Zonës Zgjedhore dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë të pambështetura në prova dhe në ligj, sepse rezultatin përfundimtar e kanë nxjerrë mbi bazën e procesverbaleve të falsifikuara.

Sipas rregullave të përgjithshme procedurale që zbaton Gjykata Kushtetuese në shqyrtimin e këtyre çështjeve çmon se kërkuesi, meqenëse ka pretenduar një të drejtë, kishte njëkohësisht edhe detyrimin që, në përputhje me ligjin, të provonte faktet mbi të cilët e bazon pretendimin e tij. Gjithashtu, përderisa ai ka pretenduar falsitetin e procesverbaleve, ishte i detyruar të paraqiste ato shkresa që vërtetojnë falsitetin dhe të tregojë emrat e dëshmitarëve, të personit të cilit i atribuohet falsiteti ose mjete të tjera provuese.

Në seancë gjyqësore nga kërkuesi u paraqitën 6 tabela rezultatesh model 54 dhe 1 model 56 (fotokopje të noterizuara) të disa qendrave të votimit, të cilat paraqesin të dhëna të ndryshme nga rezultati përfundimtar që ka nxjerrë Komisioni i Zonës Zgjedhore nr.24, duke pretenduar se këto janë procesverbalet e sakta.

Nga këqyrja e këtyre dokumenteve rezultoi se të gjitha tabelat e rezultateve të paraqitura nga kërkuesi nuk pasqyronin numrin e serisë së fletëve të votimit të përdorura. Një tabelë model 56 ishte e nënshkruar vetëm nga dy anëtarë të komisionit, ndërsa dy tabelave model 54 dhe 56 u mungonte vula e komisionit të qendrës së votimit në vendin e caktuar.

Kërkuesi nuk paraqiti përpara Gjykatës Kushtetuese provat e nevojshme për të vërtetuar këtë pretendim. Në këto kushte pretendimi i tij për falsitet konsiderohet i papranueshëm.

Një pretendim tjetër i kërkuesit lidhet me faktin se në Komisionin e Zonës Zgjedhore nr.24 ishte ushtruar dhunë psikike ndaj zëvendëskryetarit dhe për këtë arsye ai ka nënshkruar nën presion formularin model 40. Nga verifikimi i të gjithë dokumentacionit zgjedhor të kësaj zone, rezulton se ky pretendim është i pabazuar, sepse zëvendëskryetari i zonës zgjedhore nr. 24 zoti Hyrjan Hasani nuk e ka nënshkruar formularin nr.40. Gjithashtu ky person nuk ka pranuar të nënshkruajë as vendimin nr.14, datë 26.6.2001 të Komisionit të Zonës Zgjedhore nr.24, që ka shpallur deputet zotin Spartak Braho. Ky vendim është nënshkruar nga 6 anëtarët e tjerë të komisionit. Kështu që pretendimi i kërkuesit se tabelat e rezultateve dhe vendimet përkatëse janë nënshkruar nën efektin e përdorimit të dhunës fizike dhe psikike janë të pabazuara.

Ndërkohë të gjitha dokumentet e paraqitura nga zoti Spartak Braho janë të plota dhe konform kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ai paraqiti përpara kësaj Gjykate dokumentacionin e plotë të 6 qendrave të votimit të kontestuara nga kërkuesi. Për çdo qendër votimi dokumentacioni, i cili është origjinal, përmban modelin 54, 55 dhe 56, procesverbalin e pajisjes nga Komisioni i Zonës Zgjedhore të qendrave të votimit përkatëse me materialet e zgjedhjeve, si dhe procesverbalin e dorëzimit në komisionin e zonës zgjedhore të kutive të votimit dhe zarfeve me tabelat e rezultateve të votimit. Të gjitha modelet 54,55 dhe 56 i korrespondojnë numrave të serive të materialeve të marra në dorëzim dhe janë të nënshkruara pa përjashtim nga të gjithë personat që parashikon ligji. Në asnjë nga këto procesverbale nuk rezulton të jenë bërë vërejtje me shkrim nga anëtarët e komisioneve zgjedhore.

Sa më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit janë të pambështetura në ligj dhe në prova, se kërkesa e tij duhet rrëzuar dhe për rrjedhojë vendimi nr.003, datë 29.6.2001 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbetet i pacenuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “e” dhe 132 të Kushtetutës, si dhe në nenet 26 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 19.7.2001
Doli nga shtypi më 20.7.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 150 lekë